HULUMTIMI | DOKUMENTET





Në foto:
(*Majtas*) **Akropoli i kalasë së Beratit**
(*Iart*) **Mozaiku**

BERATI
Historia e emrit të një qyteti

Emrin Belgrad a Bellgrad qyteti e mbajti deri në kohën e okupacionit Turk, pas të cilit këtë emër e zëvendësojë emri Berat me të cilin quhet edhe sot. Por si u mbwrrit tek ky emërtim, cilat janë tezat dhe argumentet e studiuesve?

Dritan Çoku

Qëllimi parësor i trajtimit të emrit të qytetit të Beratit, si qytet Trashëgimi Botërore është ruajtja e substancës historike, në mënyrë që kjo substancë t'i prezantohet publikut të gjerë. Siç dimë, brenda ambjentit të këtij siti historik (Beratit), vlen në këtë rast të theksohet kalaja, mund të shfaqet një potencial i rëndësishëm arkeologjik, që mund të zgjidhë përfundimisht problemin e identifikimit të Beratit antik dhe të shuaj çdo dyshime në bazë të gjetjeve arkeologjike dhe të ketë argumentim shkencor.Rreth dy milionë vjet më parë Osumi arriti të shpërthejë pengesën e fundit të zonës malore, një kurriz të lartë gëlqeror, e të dalë lirshëm në fushën e gjerë të Myzeqesë. Me kohë, pranë grykës së ngushtë që krijoi lumi, lindi një qendër e banuar, e cila më vonë u kthye në qytet.Ky është Berati. (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, Berati historia dhe arkitektura,"8 Nëntori", Tiranë, 1988, f.5)

Berati është një nga qytetet e rralla, me zanafillën në agimet e shoqërisë njerëzore dhe me jetë të pandërprerë deri në ditët tona.

Arsyeja kryesore për të shkruar këtë artikull ishte studimi i historisë së emrit të këtij qyteti të mahnitshëm dhe ndryshimit të vazhdueshëm të tij. Përveç mjaft mbiemrave që gëzon qyteti i Beratit, vlen të theksohet fakti se, që nga kohët e lashta mbiemri "i bardhë" ka rrezatuar, ndikuar dhe duke iu imponuar në rrethana dhe periudha të ndryshme kohore dhe historike.

Emrin ky qytet e ndërroi nga shkaku i ngjarjeve të ndryshme dhe okupacioneve të huaja në kohëra që parazotëronte e drejta e të fortit. Emër të parë në kohërat e moçme ka pasur, sipas një gojëdhëne, emrin e Kështjellës me shtimin e mbiemrit i bardhë, dhe quhesh, "Kështjella e Bardhë" nga shkaku i ngjyrës së shkëmbinjëve të bardhë. Më pas, po s'dihet se kur, u quajt Orestia prej Orestit, të birit të Agamemnonit: Agamemnoni ishte komandanti i luftës kundër Trojanëve bashkë me Aqilehtin, Dushin, Mëntorin e të tjerë, si i përshkruan Homeri. Më pas, në kohën e Lekës, ose pas vdekjes së tij, dhe kjo s'dihet, u quajt Antipatria, prej Antipatrit gjeneralit të Lekës: historiani i shek.II p.e.s., Polibi për këtë qytet thotë këto: "Antipatria qytet i Elimiotidës (Mallakastër) në kufijtë e Ilirisë". (Gjergj Haxhimiali, "Berati Plak", art. Në revistën Dituria,Vol II, Nr 9,10,11, Tiranë, 1927, f.330)

Qyteti i Beratit ose Beligradi i Shqipërisë, disa thonë se është Lefki Petra (gur'i bardhë) ndërsa të tjerë se është Skambia e kjo sipas gjeografit Meletio, në pjesën ja ku përmendet Shqipëria, ose Eordhin, nga ku sipas Dhionis Pirros, autorit të biografisë të Aleksandrit të Maqedonisë, botuar në Athinë më 1846, faqe 72 thotë se që këtej kishte origjinën edhe Ptolemeu i Llagut, bir i mbretit të Maqedonisë Filipit dhe i Arsinoit, njëri nga gjeneralët më të dëgjuar (më me famë) të Aleksandrit të Madh, i cili pas vdekjes së tij në vitin 323 para krishtit jetoi në një distrikt të perandorisë së gjerë të Aleksandrisë, është bërë edhe mbret i Egjiptit. Ky sipas Dhimitrit Falirea. Zoti P.Aravantinoi, mendon se Lefki Petra duhet të jetë fshati Vranishti. (Kronografia e Epirit, f.96) Ky qytet që përmendet si Lefki Petra në Elimiotidë, gjenden në Taullandi, përkon deri diku me pozicionin e sotëm të Beratit (shih Tukididi, libri i dytë, kapitulli 99) ose Beirut dhe u quajt nga perandorët romakë Pulheriupolis, ndoshta në atë kohë kur princesha Pulheria ishte kujdestare e vëllait të saj ende të vogël Perandor Theodhosin e vogël, të cilin pas vdekjes së tij e zëvendësoi ajo duke mbretëruar sëbashku me burrin e saj Perandor Markianos deri në vitin 453 pse në këtë kohë iu shtua Perandorisë Bizantine dhe Iliria perëndimore. (Anthim Aleksudhi, Përshkrim i shkurtër historik i Metropolisë së Shenjtë të Beratit,Korfuz, 1868, f.26, f.27, f.28)

Pagëzimi me emrin e një perandori, që në latinisht ka dhe kuptimet: i pasur, i shkëlqyshëm, i fortë, tregon pa dyshim për një lulëzim ekonomik në shek.V. Në të kundërt, një qytet me një jetë të zbehtë nuk do të pagëzohej dot me këtë emër. Kjo tregon se Berati po merrte tiparet e një kryeqendre. (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, Berati historia dhe arkitektura,"8 Nëntori", Tiranë, 1988, f.13)

Në listën e tetë qyteteve administrative dhe peshkopale të Epirit të Ri, cituar nga Hierokli përmendet për herë të parë qyteti Pulheriupolis, i cili është identifikuar me Beratin. Në fakt gërmimet arkeologjike kanë provuar se muret e lashta ilire kanë qenë rindërtuar gjatë Antikitetit të Vonë dhe brenda tyre janë gjetur monedha të Justinianit, por nuk ka asnjë mbishkrim dhe as pjesë të rëndësishme arkitektonike që dëshmojnë qënien e një kishe peshkopale brenda mureve. Ka shumë mundësi që Pulheriupolis të gjendej më në lindje, në fushën e Korçës, pranë fshatit Polenë, ku janë zbuluar monumente të rëndësishme të periudhës paleokristiane, (Neritan Ceka, Ilirët, ILAR, Tiranë, 2001, f.246) Me hipotezën e mësipërme ne nuk ndajmë të njëjtin mendim sepse në Berat janë gjetur një numër i konsiderueshëm i skulpturës arkitekturore, të cilat për nga numri dhe shumëllojshmëria e tyre dëshmojnë për një numër jo të vogël monumentesh, si dhe rëndësinë e qytetit në Antikitetin e Vonë (Dritan Çoku, Të dhëna të reja mbi krishtërimin e hershëm në Berat, gazeta "Shqiptarja.com", suplementi "Rilindasi", 26 gusht 2012), aq më tepër që argument tjetër tanimë kemi zbulimin e pjesshëm deri tani të rreth 31 m² mozaik (u zbulua në gusht 2012 nga punimet që po bëheshin për hapjen e një depo uji e cila do të shërbejë për hidrantët e kalasë) në pikën më të lartë në Akropolin (fig.1, foto A.Islami) e kalasë së Beratit. Ky mozaik (fig.2, foto E.Xheka) mendojmë se është i Antikitetit të Vonë dhe mund ti përkasë një bazilike paleokristiane. Themi mund, sepse nuk lexohen akoma strukturat e mureve dhe planimetria e objektit. Teknika e punimit të ndërtimit të kësaj dyshemeje të shtruar me mozaik, orientimi i motiveve dhe mbishkrimeve në lindje - perëndim, vendodhja e mozaikut në pikën më dominuese të kalasë na i përforcon akoma edhe më shumë mendimin se ajo mund të jetë një bazilikë paleokristiane.

Mendojmë se ky mozaik është një zbulim i rëndësishëm për periudhën e paleokrishtërimit në Kalanë e Beratit (fig.3, foto A.Islami), i cili pasi të zbulohet komplet duke e çliruar nga dherat (mbushjet) do të sjellë të dhëna mjaft të vlefshme për vet monumentin, historinë e tij, por edhe për historinë e kalasë. Më e vështirë paraqitet çështja e identifikimit, kur emrat e sotëm të gërmadhave antike, dhe numri i tyre është mjaft i madh, nuk kanë asnjë lidhje me toponimet e dikurshme, të kumtuara nga autorët e lashtë, sidomos në rastet kur as të dhënat shoqëruese të këtyre vëndbanimeve nuk hedh dritë rreth pozitës së tyre dhe mund të lejojnë përcaktime të ndryshme të pozicioneve përkatëse gjeografike. (Hasan Ceka, Gjurmë të trashëgimisë ilire në toponiminë e sotme të vendit tonë, "Monumentet" 5-6, 1973, Mihal Duri, Tiranë, 1973, f.8)

Si emër antik për Beratin është propozuar shumë herë Antipatrea dhe sipas të dhënave të Livit (XXXI c.27) qyteti shtrihet në faucibus angustis, çka përshtatet në fakt shumë mirë me qytetin e sipërm të Beratit, që rri si kurorë mbi grykën e lumit. (Kamilo Prashniker, Arnold Shober, Kërkime arkeologjike në Shqipëri dhe Mal të zi, Tiranë, 2003, f.63)

Identifikimi i kështjellës ilire të Beratit me Antipatrenë përbën shembullin më tipik të pranimit të një hipoteze të pakontrolluar si një të vërtetë historike. Martin Leak, që e propozon këtë identifikim më 1835 u nis vetëm nga ngjashmëria fizike e Beratit me Antipatrenë e cilësuar nga Tit Livi (XXXI, 27,3) si "qytet që ndodhet në një grykë të ngushtë".

Duke e rimarr edhe njëherë çështjen e identifikimit të Beratit antik, duhet të shënojmë që në fillim se Antipatrea nuk vjen në konsideratë as edhe në formën e hipotezës. Një shqyrtim sado i sipërfaqshëm i tekstit të Livit tregon se fushata e Luc Apustit në vitin 200 p.e.s., gjatë së cilës rrënohet e digjet Antipatrea zhvillohet në kufijtë e Maqedonisë. Në kuptimin tradicional këto kufij ishin në lindje të krahinës ilire të Dasaretëve, ku Antipatrea përmendet për herë të parë më 216 p.e.s., së bashku me Krysondyonën dhe Gertuntin, të cilat u pushtuan nga Sherdilandi. (Neritan Ceka, Lashtësia dhe emri antik i këjshtjellës së Beratit, "Monumentet" 2/1990, GRAFIKA ARS, Tiranë, 1990, f.33)

Disa thonë se Berati, përpara se të quhej

Antipatrea, ka pasur emrin Heordhea dhe për argument përdorin luftën civile midis Lekës, përpara se t'i turret Asisë, dhe mbretit të Taulantëve Gllafqit, i shtohet, si thotë historiani bashkohës i Lekës Arjani, se Heordhea kishte kështjellë të fortë, dhe ndoshta nga ky shkak ka qenë kështjella e Beratit: po ky mendim është i pathemeltë se Heordhea ishte mbi lumin Heordhaikun (Devollin e sotëm); po ku janë këto mbeturinat e Heordhesë nuk dihet. (Gjergj Haxhimiali, "Berati Plak", art. Në revistën Dituria,Vol II, Nr 9,10,11, Tiranë, 1927, f.331) Gjithashtu i gabueshëm është dhe mendimi i atyre që thonë se Berati ka pasur dhe emrin Beirut dhe për argument marrin shkrimtarin Sozemenin: Sozemeni ishte Fenikas dhe bën fjalë për qytetin anëdetas të Finiqit, që quhesh, si dhe sot, Birito, Berut. (Po aty, f.332)

Burimet antike nuk na japin pothuaj asnjë informacion mbi qytetet ilire në prapatokën e Apolonisë deri në ngjarjet e luftës romako-maqedone. Në traktatin maqedon-kartagas të vitit 215 zotërimet romake në prapatokën e Apolonisë e formonin tokat e Antitantëve rreth Bylisit, ato të Dimalit dhe ato të parthinëve (Polib VII, 9, 13) që mbetet të kemi kryeqendër Beratin. Pas një pushtimi të shkurtër maqedon me paqen e foinikes më 205 vendoset përsëri statu quo, pas kësaj rradhe në traktatin romak-maqedon përmendim krahas Dimalit dhe parthinëve dy qytete të tjerë ilirë, Barguli dhe Eugeni (Liv XXIX 12, 13). Duke u nisur nga rrënja e emrit të qytetit të parë Barg-Bardhë që mund të jetë sllavizuar në mesjetë në Belgrad, ne kemi propozuar identifikimin e këtij qyteti në Berat. (Neritan Ceka, Lashtësia dhe emri antik i kështjellës së Beratit, "Monumentet" 2/1990, GRAFIKA ARS, Tiranë, 1990, f.34) Ky mendim është kundërshtuar nga Pajakovski dhe S.Islami, të cilët e kërkojnë qytetin ilir të Bargulit në fshatin Bargullas në afërsi të Beratit, ku toponimi shumë i ngjashëm (Bargul-Bargullas) lidhet edhe me ekzistencën e një kështjelle antike. Këto dhe fakti që Barguli, ndryshe nga Antipatrea, në burimet e shkruara, përmendet vetëm njëherë, na duken bindëse. (Hëna Spahiu, Qyteti iliro-arbëror i Beratit, Mihal Duri, Tiranë, 1990, f.85) Mjaft i mundshëm mbetet edhe një identifikim tjetër, parashtruar nga Th.Kacorri, për të identifikuar në Berat kryeqendrën e parthinëve. Parthën, me të njëjtën linjë Parthë-bardhë-Belgrad. Nga pikpamja historike kjo hipotezë gjen mbështetje në faktin se parthinët përmenden shpesh në prapatokën e Apolonisë, por ata na dalin edhe prapa Dyrrahut. Ku gjendej kryeqendra e tyre Partha? Për këtë na ndihmon një pasazh i Çaparit i cili pushton oppidum parthinorum (B.91, 1) pra Parthesi gjatë marshimit nga kampi i tij pranë lumit Aps (Osumit) deri në Asparag, pranë Genusit (Shkumbinit). Në këtë hapësirë ka vetëm dy qytete të rëndësishëm Berati dhe Belshi, por duke u nisur nga fakti se në Parthë kishte një garnizon të Pompeut, vjen në konsideratë kështjella e Beratit, fortifikimet e së cilës ishin shumë më të ngushta se muret e dobëta të Belshit. (Neritan Ceka, Lashtësia dhe emri antik i kështjellës së Beratit, "Monumentet" 2/1990, GRAFIKA ARS, Tiranë, 1990, f.34) Në një mbishkrim të zbuluar në kalanë e Beratit lexohet: "Më zbukuroj një mik atëror, kurse atdheu Patrai më dhuroi, por unë zotëroj fushën e Gylakut" (Myzeqenë). Nëse ky nuk është epigram i një të ardhuri nga Patrasi, pak e mundshme kjo në kundërshtim me përmbajtjen, do t'i shkonte për shtat binomit Patrai-Antipatrai, qytet-kështjellë. Në të vërtetë forma me anti përkundruall është e rëndomtë për vendbanimet e kësaj kohe, që ndodhen përballë njeri-tjetrit (Bar-Antibar, Kapri-Antikapri etj.). (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, Berati historia dhe arkitektura,"8 Nëntori", Tiranë, 1988, f.12) Hipotezat për identifikimin e Beratit ende nuk gjejnë argumentim shkencor. (Kujtim Braka, Berati në dritën e të dhënave



Kalaja e Beratit

arkeologjike," Monumentet" 2/1990, GRAFIKA ARS, Tiranë, 1990, f.97)

Në vitin 168 p.e.s. u thye mbreti i fundit i Ilirisë. Genti u pushtua prej Romanëve dhe Berati ndërroi prapë emrin: Romanët duke vëzhguar muret dhe shkëmbinjtë e bardhë të Kështjellës, gjithashtu dhe petkat e bardha, që kishin përgjithësisht banuesit, si xhoka, kallsa, mëngore, fustanella, të cilat dhe sot, po në shumë pak vënde, veshin, nga fjala Shqipe i bardhë, banuesit i quajti Bardhinos dhe qytetin Bardhinorum Oppidum. Po ky qytet me këtë emër, në atë kohë, nuk ka të përpjekur dhe s'duhet të ndërlikohet me qytetin Parthinorum oppidum, i cili ishte në veri dhe jo në jug të Savrës, e cila ca shekuj më pas u quajt, si quhet dhe sot, Myzeqe prej Gjon Muzakës. (Gjergj Haxhimiali, "Berati Plak", art. Në revistën Dituria,Vol II, Nr 9,10,11, Tiranë, 1927, f.330)

Në periudhën e vonë antike, në shekujt IV-VI, invazionet u bënë të zakonshme në Epirin e ri. Për t'u mbrojtur prej tyre, në rrugët kryesore dhe përreth qyteteve u ndërtua një sistem i fuqishëm mbrojtës. Emri i qytetit rigjendet në listën e fortifikimeve të ndërtuara në shekuj në një trajtë paksa të deformuar, Antipagrai. (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, Berati historia dhe arkitektura,"8 Nëntori", Tiranë, 1988, f.12) Sipas Prof. Dr. Guntram Koch është e mundëshme të kemi të bëjmë me një lajthitje në shkrim ku të jetë përdorur në vend të "Tau" (?) "Gamma" (?), kështu do të kishim Antipatrai-Antipatreia, Beratin tonë. (Guntram Koch, Disa dëshmi të periudhës së hershme bizantine në Berat," Monumentet" 2/1990, GRAFIKA ARS, Tiranë, 1990, f.113)

Mesa duket në kohën e dyndjeve të bullgarosërbëve në viset e Epirit, Maqedonisë dhe Ilirisë, e të pushtimit të tyre, u quajt Belgrad, në përkthim të emrit grek "Lefki Polis" ose "qyteti i bardhë" dhe në sllavisht u quajt tani "Bielo dhe Giord" ose "Grod". Në saj të këtij emërtimi të ri të qytetit, peshkopët paruardhës, në këtë vend firmonin në këtë mënyrë: Belgrad, Bellagrad, Belograd, Belgrad, për t'i dalluar nga Mitropolitët e Beligradit ose Beogradit të Serbisë. (Anthim Aleksudhi, Përshkrim i shkurtër historik i Metropolisë së Shenjtë të Beratit,Korfuz, 1868, f.28)

Në shek.X u quajt prej Bullgarëve Bullgjeropojë, ndoshta me ndërlikimin e fjalës Pulqeriopojë ose të mbiemrit latin pulcher (shqip pulqer) = i bukur. (Gjergj Haxhimiali, "Berati Plak", art. Në revistën Dituria,Vol II, Nr 9,10,11, Tiranë, 1927, f.332) Riemërtimi i qytetit nga Pulheriopol në Belgrad ndodhi në periudhën e dytë të pushtimit bullgar (976-1018). (A.Baçe, A.Meksi, E.Riza, Berati historia dhe arkitektura, "8 Nëntori", Tiranë, 1988, f.15).

Pagëzimi me emrin e një perandori, që në latinisht ka dhe kuptimet: i pasur, i shkëlqyshëm, i fortë, tregon pa dyshim për një lulëzim ekonomik në shek.V. Në të kundërt, një qytet me një jetë të zbehtë nuk do të pagëzohej dot me këtë emër

Në Perandorinë Osmane ekzistojnë tani katër kështjella të përmendura me emrin Beligrad: e para është Beligradi i Tunës, që ndodhet pranë bregut të lumit Danub, e dyta gjendet në kufirin e Budinit (Hungari) me largësi pak më tepër se sa një ditë rrugë dhe që quhet Beligradi Stoln, e treta është Beligradi i Ardelit, (në Transilvani) që është përsëri në sundimin e osmanëve, dhe e katërta është Beligradi i Shqipërisë. (Vafsi Samimi, Berati "300 vjet më parë",Një studim mbi Evlija Çelebiun mbi qytetin dhe kështjellën e Beratit, Dita 2000, Tiranë, 1971, f.27) .

Emrin Belgrad a Bellgrad qyteti e mbajti deri në kohën e okupacionit Turk, pas të cilit këtë emër e zëvendësojë emri Berat me të cilin quhet edhe sot. Për këtë emër janë disa mendime: i pari, se fjala Berat u bë me shkurtim prej fjalës Bel-grad: ky mendim në sipërfaqe duket i lehtë për shpjegim, ndonëse dhe fjala Bel-grad është dhe ajo dyrrokëshe: po mendimi i dytë i bazuar në argumente historike, sipas gojëdhënës së pleqëve dhe sipas mënyrës që përdornin turqit, kur pushtonin vendet e huaja pa kundërshtim, është më i shëndoshë, dhe është ky: banuesit e vendit, duke menduar se kundërshtimi te turqit, që kishin pushtuar përpara ca vjetëve përveç Janinës dhe Gjirokastrës (Gjergj Haxhimiali, "Berati Plak", art. Në revistën Dituria,Vol II, Nr 9,10,11, Tiranë, 1927, f.332) dhe vise të tjerë pak orë larg nga jugu i Beratit, dhe ca më tepër shkaku që s'ishin të bashkuar me qarkun e qytetit për kundërshtim, u shtrënguan të bëjnë një marrëveshje për dorëzimin e qytetit dhe të kështjellës pa luftë. Kur bëhesh dorëzimi i një kështjelle a qyteti me të tillë mënyre, sulltani, sipas zakonit të tij në atë kohë, u dhuronte banuesve disa privilegje, për të cilët bënte një ferman të veçantë, që quhesh "berat" d.m.th. qyteti u quajt qytet me privilegje, qytet me ferman "berati" dhe kështu emri i fermanit zëvendësojë emrin Belgrad. Po të këtij mendimi janë dhe arkeologu restaurator Gjergj Frashëri dhe Ing. Restaurator Sulejman Dashi se është pikërisht diploma mbretërore (berati), emri që zuri vend në gojën e popullsisë për ta dalluar këtë qytet nga të tjerët, si "Beligradi me berat" apo "qyteti me berat", në kuptimin e qytetit me privilegje, megjithëse në praktikat shtetërore osmane deri në shekullin e fundit ai vazhdonte të cilësohej akoma si Beligradi shqiptar. (Gjergj Frashëri, Sulejman Dashi, Fillimet e artit islamik në qytetin e Beratit,"Monumentet" 1/1988, Tiranë, 1988, f.106) Është për të vënë re se, dhe megjithëse pas okupacionit turk ky qytet ndërrojë emrin për shkakun e lartëpërmendur, Kryepeshkopi Ortodoks nuk e ndërrojë titullin dhe titullohej si dhe më përpara Mitropolis Velgradon, Kaninis qe Spathias, ipërtimos qe eksarkos pasis Allvanijas…

Ky titull vazhdoi deri në kohën e rilindjes së Atdheut, ose më mirë me thënë, deri në kohën e Kongresit Ortodoks, që u bë këtu në Berat dhe më 12 Shtator 1922 proklamojë kishën Autoqefale Ortodokse të Shqipërisë, dhe Mitropoliti Kristofori, pas instalimit në selinë e Mitropolisë më 24 Dhjetor 1923, titullohet qysh prej kësaj kohe "Mitropoliti i Beratit dhe i Vlorës". (Gjergj Haxhimiali, "Berati Plak", art. Në revistën Dituria,Vol II, Nr 9,10,11, Tiranë, 1927, f.333)

Ruajtja e pasurisë kulturore në përgjithësi, dhe asaj ndërtimore në veçanti, kanë qenë një përkujdesje e vazhdueshme e gjeneratave të kombit tonë, e krijuesve të këtyre vlerave në rrjedhë të shekujve. Tashmë, shoqëria jonë është bërë e ndërgjegjëshme se e kaluara dhe e tashmja janë hallka të një zinxhiri, dhe se këto do të shërbejnë si bazë për ndërtimin e së ardhmes. (Emin Riza, Qyteti muze i Beratit, arritje dhe perspektivat," Monumentet" 2/1990, GRAFIKA ARS, Tiranë, 1990, f.9) Vlerat e një rëndësie të veçantë, të cilat ruhen në qytetin e Beratit janë një larmi gjinish e pasurish artistiko-kulturore. Qëllimi parësor i trajtimit të emrit të qytetit të Beratit, si qytet Trashëgimi Botërore është ruajtja e substancës historike, në mënyrë që kjo substancë t'i prezantohet publikut të gjerë. Siç dimë, brenda ambjentit të këtij siti historik (Beratit), vlen në këtë rast të theksohet kalaja, mund të shfaqet një potencial i rëndësishëm arkeologjik, që mund të zgjidhë përfundimisht problemin e identifikimit të Beratit antik dhe të shuaj çdo dyshime në bazë të gjetjeve arkeologjike dhe të ketë argumentim shkencor. Është e domosdoshme që siti (në rastin tonë qyteti i Beratit) të menaxhohet me shumë kujdes, duke u siguruar që të gjitha veprimet të shqyrtohen në përputhje me kërkesat e Konventës se Trashëgimisë Botërore.